

VENDIM
Nr. 584, datë 10.9.2014

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR “AKADEMIA BOTËRORE E TIRANËS” (WORLD ACADEMY
OF TIRANA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana) nga subjekti, shoqëria “Montessori Albania”, sh.p.k.
2. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” do ta ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: rruga “Bilal Golemi”, nr. 17, Tiranë.
3. Në institucionin arsimor privat para-universitar “Akademia Botërore e Tiranës”, mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj anglisht. Në lëndët: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë, mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.
4. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” do të ofrojë arsimim parauniversitar në nivelin e arsimit të mesëm të lartë - gjimnaz dhe forma e arsimimit do të jetë arsimim me kohë të plotë.
5. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës”, me fillimin dhe gjatë veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, për:
 - a) numrin e nxënësve, që do të fillojnë e do të mbarojnë vitin shkollor, dhe listën e mësuesve sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;
 - b) planin mësimor dhe programet e lëndëve që do të zhvillojë institucioni;
 - c) strukturën e vitit shkollor që do të ketë institucioni, e cila duhet të jetë e barasvlefshme me atë të shkollave publike të të njëjtit nivel, së bashku me kalendarin e veprimtarive vjetore të institucionit;
 - ç) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
 - d) lëndët mësimore të detyrueshme njëloj me ato të shkollave publike;
 - dh) lëndët mësimore të ndryshme nga ato të planeve mësimore të institucioneve ekuivalente publike;
 - e) lëndët me zgjedhje dhe ato fakultative.
6. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të ketë regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore, regjistra të përkohshëm, rregullore të brendshme për funksionimin e institucionit, si dhe çdo dokumentacion që ky institucion e përdor si dokument bazë.
7. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si dhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik, që kërkon të kryejë sipas rastit.
8. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës, që mund të pësojë institucioni arsimor privat, shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pas miratimit nga njësia arsimore vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.
9. Institucioni arsimor privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje të gjitha të dhënat sipas standardeve të miratuara nga Instituti i Statistikave, si dhe të dhëna të tjera më të hollësishme, që mund të kërkohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për veprimtarinë e tyre arsimore.
10. Dokumentacioni i institucionit arsimor privat parauniversitar dhe të dhënat e tjera, përcaktuar në

këtë vendim, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihen në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

11. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të funksionojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore private dhe të institucioneve arsimore plotësuese private, që zhvillojnë mësimin në gjuhë të huaj, në përputhje me konventat, traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke respektuar realitetin shqiptar, arritjet dhe traditat e shkollës kombëtare shqiptare.

12. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo do të kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësia arsimore vendore, nën juridiksionin e së cilës është ky institucion arsimor, dhe institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama